



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 gusht 2024
Nr. ref.: RK 2512/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI282/23

Parashtrues

Fehmi Pozhegu

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-22-0440-A0001] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 30 nëntorit 2023

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fehmi Pozhegu, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [AC-I-22-0440-A0001] e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) të 30 nëntorit 2023.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenet: 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe neni 1 i Protokollit numër 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 28 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI282/23 caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI282/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
7. Më 19 janar 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje të kërkesës së parashtruesit iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 10 shtator 2015, Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore "Erneniku Prodhimtaria Primare" refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kërkoi kompensim financiar për ngastrën [nr. 4621] me sipërfaqe prej 088.76 ha, në Gjakovë.
11. Më 19 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit për refuzimin e kërkesës.

12. Më 7 prill 2022, DHPGJS-ja lëshoi urdhrin [C. III-15-0671] me të cilin i kërkoi parashtruesit të kërkesës të plotësonte padinë, të paguante taksën gjyqësore dhe e njoftoi për pasojat juridike të mosveprimit.
13. Më 14 prill 2022, parashtruesi i kërkesës e pranoi urdhrin përmes dorëzimit postar.
14. Më 26 prill 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë me të cilën kërkoi që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore dhe një afat shtesë për plotësimin e ankesës.
15. Më 13 maj 2022, DHPGJS-ja përmes Aktvendimit [C. III-15-0671] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore dhe ia caktoi një afat shtesë prej 15 ditëve për plotësimin e ankesës.
16. Më 19 maj 2022, parashtruesi i kërkesës e pranoi Aktvendimin [C. III-15-0671] e DHPGJS-së. Parashtruesi i kërkesës nuk e pagoi taksën gjyqësore dhe nuk e plotësoi ankesën.
17. Më 18 korrik 2022, DHPGJS-ja përmes Aktvendimit [C. III-15-0671] e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se ky i fundit nuk e ka paguar taksën gjyqësore përkundër pranimit të urdhrin për pagesë. DHPGJS-ja argumentoi se Udhëzimi administrativ [Nr. 01/2017] për unifikimin e tarifave gjyqësore (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi administrativ), përcakton detyrimin e palëve për të paguar taksën gjyqësore, në të kundërtën padia do të konsiderohet e tërhequr. DHPGJS-ja konstatoi se parashtruesi i kërkesës e pranoi urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore më 19 maj 2022, mirëpo nuk e solli dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore.
18. Më 5 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Kolegjin e Apelit, përmes së cilës e kundërshtoi vendimin e DHPGJS-së për tërheqjen e padisë. Parashtruesi i kërkesës pretendoi që aktvendimi ishte marrë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse ai e kishte njoftuar gjykatën që nuk kishte mundësi financiare për pagesën e taksës gjyqësore.
19. Më 6 shtator 2022, zyra për financa e DHPGJS-së kërkoi nga parashtruesi i kërkesës pagesën e taksës gjyqësore për parashtrimin e ankesës në Kolegjin e Apelit.
20. Më 15 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore për shkak të gjendjes së vështirë financiare sepse ishte pensionist.
21. Më 6 tetor 2023, Kolegji i Apelit përmes një urdhri kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të sillte prova që dëshmonin se është pensionist apo që është në gjendje të vështirë sociale.
22. Më 16 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës përsëriti kërkesën e tij në Kolegjin e Apelit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore sepse është pensionist dhe ka të hyra mujore në vlerë prej 198.00 euro.
23. Më 30 nëntor 2023, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I-22-0440-A0001] e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër aktvendimit të DHPGJS-së, për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore. Kolegji i Apelit theksoi se pas kërkesës së parashtruesit të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, i kërkuan atij të sillte prova që dëshmonin për gjendjen e vështirë financiare, mirëpo ai nuk ofroi asnjë provë dhe nuk e pagoi taksën gjyqësore. Kolegji i Apelit arsyetoi se, paragrafi 4 i nenit 253 i Ligjit të Procedurës Kontestimore [në tekstin e mëtejme: LPK] përcakton që *“paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar”*. Ndërkaq, paragrafi 5 i nenit 253 i LPK-së parasheh se *“në qoftë se paditësi*

nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës thekson se e kishte njoftuar Kolegjin e Apelit që nuk kishte mundësi financiare për pagesën e taksës gjyqësore, mirëpo pavarësisht kësaj ankese e tij u konsiderua e tërhequr.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon që “*me asnjë dispozitë ligjore, as me LPK e as me Udhëzimin administrativ nuk parashihet mundësia që të trajtohet e tërhequr ankesa*”, prandaj është zbatuar gabimisht e drejta materiale dhe dispozitat e LPK-së. Sipas parashtruesit të kërkesës, e drejta e ankesës është kategori kushtetuese dhe mohimi i saj përbën mohim të qasjes në drejtësi.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [C-III-15-0671] i DHPGJS-së dhe Aktvendimi [AC-I-22-0440-A0001] i Kolegjit të Apelit janë në kundërshtim me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në lidhje me nenet: 6 [E drejta për një proces të rregullt], 13 [E drejta për ankim efektiv] dhe nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...].*

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Përmbajtja e padisë

Neni 253

[...]

253.4 Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 01/2017 PËR UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE

Neni 3

[Përcaktimi i taksave për parashtresat lidhur me kërkesat civile]

[...]

Përcaktimi i lartësisë së taksave gjyqësore që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtesës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit, gjegjësisht llojit të parashtesës, duke u bazuar në Tarifën për taksa gjyqësore të këtij Udhëzimi (TTGJ).

Neni 5

[Mbledhja e taksave dhe pasojat e mospagesës]

[...]

5.5 Përcaktimi i lartësisë së taksave gjyqësore që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtesës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit, gjegjësisht llojit të parashtesës, duke u bazuar në Tarifën për taksa gjyqësore të këtij Udhëzimi (TTGJ).

5.5.1 Nëse taksa për parashtresë nuk paguhet deri në datën përfundimtare sipas këtij neni dhe kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi për pagesën e saj, gjykata do të hedh poshtë parashtresën me përjashtim të parashtresave lidhur me mjetet e goditjes

5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253, paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr.

[...]

Neni 8

Lirimi nga pagesa e taksave

8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si në vijim:

8.1.1 personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla

8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai

[...]

8.3 Kategoritë e personave nga neni 8.1, për t'u liruar nga taksat duhet të sigurojnë këto prova:

8.3.1 dëshmi se ai/ajo është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

Neni 21

[Parimet e përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

29. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

30. Përkritazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-22-0440-A0001] e Kolegjit të Apelit, të 30 nëntorit 2023, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
31. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34

[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

[...]

32. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).
33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimi i Kolegjit të Apelit - që e konsideroi të tërhequr ankesën për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore, është në kundërshtim me nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës do t’i shqyrtoj në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, përkitazi me “qasjen në gjykatë”.

Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit e konsideroi të tërhequr ankesën e tij për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore, përkundër që e kishte njoftuar se nuk kishte mundësi financiare për ta bërë pagesën e taksës gjyqësore.
35. Gjykata rithekson se kërkesa për të paguar taksë në lidhje me paditë apo ankesat që parashtrohen në çështje civile, nuk mund të konsiderohet si kufizim i të drejtës për “qasje në gjykatë” dhe në vetvete nuk është në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata rikujton se në praktikën e saj gjyqësore kishte vendosur në disa raste për çështjen e mospagesës së taksës gjyqësore pranë DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit. Kur parashtruesit e kërkesës nuk e kishin paguar taksën gjyqësore përkundër pranimit të vërejtjes për pagesë, Gjykata nuk kishte konstatuar shkelje dhe kishte legjitimuar vendimet e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Apelit (shih, rastet e Gjykatës, [KI57/19](#), parashtrues *Slavica Mirić*, Aktvendim për papranueshmëri i 12

- dhjetorit 2019, paragrafët 47-55; [KI62/18](#), parashtrues *Nadlije Gojani*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 shtatorit 2018, paragrafët. 35-49; [KI78/18](#), parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 shkurtit 2019, paragrafët. 38-45; [KI29/23](#), parashtrues *Bashkim Buçuku*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 majit 2023, paragrafët. 38-44).
36. Gjykata kishte konstatuar shkelje kur Kolegji i Apelit e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës pa e shqyrtuar fare kërkesën e tij për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore (shih, rasti i Gjykatës, [KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafët. 49-53); dhe kur Kolegji i Apelit e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës pa e shqyrtuar fare kërkesën për zgjatje të afatit të pagesës së taksës gjyqësore (shih, rasti i Gjykatës, [KI80/19](#), parashtrues *Radomir Dimitrijević*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2020, paragrafët. 55-60).
37. Gjykata vëren se, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në DHPGJ-së kundër Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore “Ereniku Prodhimtaria Primare”, me të cilën kërkonte kompensim financiar për një pronë të paluajtshme në sipërfaqe prej 088.76 ha. DHPGJS-ja nxori një vendim dhe i kërkoi parashtruesit të kërkesës të paguante taksën gjyqësore në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë për t’u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për shkak të pamundësisë financiare, e cila u refuzua nga DHPGJS-ja. Pasi që parashtruesi i kërkesës nuk e pagoi taksën gjyqësore, DHPGJS-ja e konsideroi të tërhequr padinë.
38. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës deponoi një ankesë në Kolegjin e Apelit kundër vendimit të DHPGJS-së për tërheqjen e padisë, me arsyetimin se e kishte njoftuar DHPGJS-në se nuk kishte mundësi financiare ta paguante për shkak se ishte i papunësuar. Kolegji i Apelit e lëshoi një urdhër me të cilën i kërkoi parashtruesit të kërkesës pagesën e taksës gjyqësore për ankesën. Parashtruesi i kërkesës përsëri parashtrroi kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore me arsyetimin se nuk kishte mundësi financiare ta realizonte pagesën. Kolegji i Apelit përmes një urdhri të ri kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të paraqiste prova që do të mund të dëshmonin gjendjen e vështirë financiare për ta kryer pagesën e taksës gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës iu përgjigj Kolegjit të Apelit se është pensionist dhe ka të ardhura të ulëta financiare, në shumën prej 198.00 euro. Megjithatë, Kolegji i Apelit nuk e pranoi si provë arsyetimin e tij dhe e konsideroi të tërhequr ankesën.
39. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës përmes ankesës në Kolegjin e Apelit do të kishte mundësi të adresonte pretendimet e tij kundër vendimit të DHPGJS-së që ia konsideroi të tërhequr padinë e tij për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës e humbi mundësinë që ankesa e tij të trajtohet në merita nga Kolegji i Apelit për shkak se nuk e pagoi taksën gjyqësore për ankesën. Prandaj, Gjykata nuk do të trajtojë çështjen e pagesës së taksës gjyqësore pranë DHPGJS-së, por do të analizojë vendimin e dytë të Kolegjit të Apelit që ia konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër vendimit të DHPGJS-së.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se zyra për financa e DHPGJS-së kërkoi nga parashtruesi i kërkesës pagesën e taksës gjyqësore për parashtrimin e ankesës në Kolegjin e Apelit. Parashtruesi i kërkesës në momentin e pranimit të njoftimit për pagesën e taksës gjyqësore, parashtrroi kërkesë për lirim nga pagesa me arsyetimin se nuk kishte mundësi financiare të realizonte pagesën. Kolegji i Apelit nxori një urdhër të ri dhe kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të paraqiste prova që dëshmonin gjendjen e vështirë financiare për pagesën e taksës gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës iu përgjigj Kolegjit të Apelit se ishte pensionist dhe kishte të hyra financiare në vlerë prej 198.00, të cilat i konsideronte të pamjaftueshme për pagesën e taksës gjyqësore. Megjithatë,

Kolegji i Apelit nuk e pranoi si provë arsyetimin e tij dhe e konsideroi të tërhequr ankesën.

41. Gjykata vëren se, neni 8 [Lirimi nga pagesa e taksave] i Udhëzimit administrativ, e parasheh mundësinë për lirim nga pagesa të taksës gjyqësore, ndër të tjera edhe për personat me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tyre apo të anëtarëve të familjes. Sipas paragrafit 3, të nenit 8 të Udhëzimit administrativ, personat duhet të sjellin dëshmi që janë përfitues të ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pra, barra e përgjegjësisë për të siguruar provat dhe për të dëshmuar vështirësinë ekonomike për pagesën e taksës gjyqësore bie mbi palët. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës përpos njoftimit se ishte pensionit dhe realizonte të hyra financiare të ulëta në vlerën prej 198.00 euro, nuk kishte sjellë dëshmi pranë Kolegjit të Apelit siç kërkon udhëzimi administrativ. Për këtë arsye, Kolegji i Apelit vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar prova në lidhje me kërkesën për mospagesën e taksës gjyqësore dhe e konsideroi të tërhequr ankesën e tij.
42. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ishte në gjendje të vështirë ekonomike dhe të lirohej nga pagesa e taksës gjyqësore. Është në autoritetin e gjykatave të rregullta të bëjnë vlerësime në lidhje me gjendjen ekonomike të palëve dhe lirimin eventual të tyre nga pagesa. Ajo se çfarë është me rëndësi për Gjykatën është që Kolegji i Apelit veprimi sipas dispozitave ligjore në lidhje me pagesën e taksës gjyqësore; e trajtoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore dhe i ofroi mundësinë për ta dëshmuar vështirësinë e tij ekonomike.
43. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me mospagesën e taksës gjyqësore, janë pretendime “me mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”, prandaj duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 17 korrik 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Grësa Caka-Nimani

